

Për prindërit dhe kujdestarët: Mirë se vini në kujdesin për adoleshentë

Ekipi juaj i kujdesit:

Orari i vizitave:

Lini ose anuloni takime:

Mirë se vini në shtëpinë tuaj mjekësore në klinikën e mjekësisë për adoleshentë. Shtëpia mjekësore është një partneritet i besuar mes një ekipi kujdesi shëndetësor dhe një pacienti dhe kujdestari të informuar. Ne ofrojmë kujdes cilësor shëndetësor për adoleshentë dhe të rritur në moshë të re.

Ashtu si me pacientët më të vegjël, synimi ynë është të ndihmojmë fëmijën tuaj të sillet në një mënyrë që e ndihmon të jetë i shëndetshëm, t'i identifikojë problemet shëndetësore që herët dhe të ofrojmë kujdes shëndetësor me cilësi maksimale. Fëmija juaj rritet dhe trupi, sjellja dhe nevojat e kujdesit shëndetësor për të ndryshojnë. Për këtë arsye ndryshon edhe mënyra se si e ofrojmë kujdesin shëndetësor. Është e rëndësishme t'i ruani ekzaminimet vjetore shëndetësore të fëmijës suaj, si dhe vizitat e rregullta për vaksinat, ekzaminimet e specializuara apo çfarëdo problemesh që mund të lindin.

Teksa adoleshentët fillojnë të zhvillohen në të rritur dhe të marrin më shumë përgjegjësi për jetën e tyre, ne u kërkojmë më shumë pjesëmarrje në lidhje me shëndetin e tyre. Ndonëse fëmijët e vegjël kanë nevojë për praninë e prindit apo të kujdestarit në dhomë për t'u ndjerë të sigurt dhe për të dhënë informacion të saktë të historikut mjekësor, adoleshentë kanë nevojë për pak kohë private të vetëm me ofruesin e tyre mjekësor. Si pjesë e kujdesit tërësor shëndetësor, **ne kemi për praktikë t'u kërkojmë prindërve/kujdestarëve që të presin përjashta për një pjesë të intervistës dhe të ekzaminimit fizik, si dhe i rekomandojmë adoleshentit që ta diskutojë problemin nga pikëpamja e vet.** Diskutimi me adoleshentët pa praninë e prindit u jep adoleshentëve rastin të bëjnë pyetje ose të japin informacion për të cilin mund të kenë drojë. Ndërsa e kuptojmë se disa adoleshentë mund të flasin me prindërit e tyre për këto çështje, shumë prej tyre u vjen zor t'i diskutojnë shqetësimet e tyre përpara prindit apo kujdestarit. Ndonjëherë adoleshentët mund ta fshehin sjelljen e tyre, ndaj prindi/kujdestari mund të mos jetë i pari që e vë re. Synimi ynë është t'i ndihmojmë të parandalojnë dhe identifikojnë këto sjellje përpara se të bëhen problematike.

Legjislacioni i shtetit të Nju-Jorkut na kërkon që disa shërbime t'ua ofrojmë në fshehtësi adoleshentëve. Adoleshenti juaj mund t'i marrë këto shërbime edhe vetë në çfarëdo qendre shëndetësore. Në shumicën e rasteve këto shërbime do të jenë konfidenciale dhe falas. Me ofrimin e këtyre shërbimeve në fshehtësi, synimi ynë është që adoleshenti të ketë besim te ne që të na i tregojë plotësisht shqetësimet që mund të ketë dhe që të mund ta ndihmojmë të zgjedhë sjellje të shëndetshme. Kalimi i përgjegjësisë për shëndetin tek adoleshenti juaj mund ta inkurajojë t'i përvetësojë vetë sjelljet më të shëndetshme. Njëherësh, **ne i inkurajojmë gjithashtu pacientët tanë adoleshentë që t'i diskutojnë pyetjet apo problemet e mundshme të rëndësishme që mund të kenë me një prind apo kujdestar në rastin më të parë.**

Është gjithashtu e rëndësishme për ju të dini se nëse fëmija juaj bën diçka që lëndon atë vetë apo të tjerët, të mos e mbajmë këtë konfidenciale, por ta diskutojmë me një të rritur të përshtatshëm.

Ekipi i mjekësisë për adoleshentë është në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të diskutuar problemet shëndetësore me ju dhe me adoleshentin tuaj. Ne duam të punojmë së bashku me ju për ta ndihmuar adoleshentin apo të rriturin tuaj në moshë të re të marrë vendimet më të mira për një të ardhme të shëndetshme.

Vizita shëndetësore e adoleshentit

Adoleshentët duhet ta vizitojnë rregullisht ofruesin e tyre të kujdesit parësor. Akademia Amerikane e Pediatriisë (American Academy of Pediatrics) dhe disa organizata të tjera rekomandojnë vizita të paktën vjetore. Kur bëni vizitën tuaj, mund të prisni procedurat e zakonshme:

- Matjen e gjatësisë, peshës dhe tensionit; matjen e rritjes së përgjithshme dhe të zhvillimit pubertal
- Analiza depistimi për shikimin dhe dëgjimin
- Një ekzaminim të plotë fizik
- Vaksinimet
- Vlerësimin e problemeve të mundshme kronike mjekësore

Teksa fëmijët rriten drejt moshës së pjekurisë, vizitat tek ofruesi fillojnë të përfshijnë:

- Diskutime për performancën në shkollë, marrëdhëniet me shokët dhe planet për të ardhmen
- Vlerësimi i rrezikut dhe orientimi parandalues në lidhje me shëndetin mendor, lëndimet, përdorimin e substancave, seksualitetin, kontraktivët, infeksionet me transmetim seksual (STI), nutricionin, fizikulturën dhe pjesëmarrjen në sporte
- Diskutime në lidhje me sëmundjet e transmetueshme seksuale (STI), analizat dhe parandalimin
- Diskutime në lidhje me HIV dhe SIDA-n, analizat dhe parandalimin

Shërbime të tjera që ofrohen në klinikë ose me referim nëse nevojitet:

- Ekzaminime fizike gjatë studimeve dhe pjesëmarrjes në sporte
- Shërbime konsulence për kontraktivë
- Vlerësime për çrregullime të ngrënies
- Shërbimet mbështetëse për LGBTQ+
- Referime për shërbime të shëndetit mendor/emocional
- Konsulencë dhe referime për nutricion, fizikulturë dhe stil jetese
- Asistencë punonjësi social
- Referime për lënien e duhanit
- Referime për ofrues të tjerë mjekësorë dhe specialistë kirurgjie

Burime në internet

Nycyouthhealth.org

Nyc.gov/teen

Aap.org

Youngwomenshealth.org

Youngmenshealthsite.org